



Republika e Shqipërisë  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

**DOGANA  
CUSTOMS**

# Libri Jeshil 2022

---

Prioritetet 2023





**DOGANA  
CUSTOMS**

**ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE**

**Libri Jeshil 2022**

**Prioritetet 2023**



**ADSH**  
**ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

[www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)

Tel: +355 42 232 988 Cel: +355 684053453

Email: [helpdesk.dpd@dogana.gov.al](mailto:helpdesk.dpd@dogana.gov.al)



Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjja Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës,  
km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

## ***Parathënie***

Libri Jeshil u botua për herë të parë gjatë vitit 2022 me objektivin për rritjen e transparencës së Administratës doganore me partnerët, biznesin dhe qytetarët.

Në përmbajtjen e Librit Jeshil përfshihen kryesisht informacione sintetike lidhur me planet e veprimit dhe strategjitë e Administratës doganore që kanë ndikimin kryesor në realizimin e objektivave sipas Kodit Doganor:

mbrojtjen e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;

- garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj,
- mbrojtje mjedisit në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera si edhe,
- mbajtjen e ekuilibrit të duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

I konceptuar në formatin e një raporti vjetor, Libri Jeshil fillon me fjalën e Drejtorit të Përgjithshëm si një përmbledhje e arritjeve dhe sfidave të Administratës Doganore, vijon me Organigramën e re të ADSH, performancën dhe statistikën kryesore, aktivitetet ligj zbatuese, lehtësimin e procedurave, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe prioritetet e vitit 2023.

Duke ju uruar një lexim të këndshëm, Administrata Doganore ju falënderon për vëmendjen dhe ju fton të bashkëpunojmë me synimin për modernizimin drejt një Sistemi Doganor me standardet evropiane.

## Përmbajtja:

- I. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Misioni
- II. Organigrama
- III. Zhvillimet kryesore
- IV. Performanca e të ardhurave nga Doganat
- V. Zbatimi ligjit(DOH)
- VI. Lehtësimi procedurave Doganore
- VII. Marrëdhëniet ndërkombëtare
- VIII. Rritja Kapaciteteve Administrative
- IX. Prioritetet 2023
- X. Kontaktet



## I. Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave

### Z. Genti Gazheli

Viti 2022 ishte sfidues për doganat por, pavarësisht efekteve të zgjatura të tërmetit, pandemisë dhe konfliktit Rusi-Ukrainë, Administrata Doganore ka shërbyer me përgjegjësi dhe profesionalizëm duke kontribuar për tregtinë e hapur e të ndershme.

Respektimi dinjitetit të çdo biznesi ose qytetari që paraqitet në doganë, zgjidhja e problemeve, lehtësimi tregtisë së ligjshme dhe barazia para ligjit, kanë qenë parimet kryesore të Doganave gjatë vitit 2022!

Realizimi rekord historik i të ardhurave doganore, që për vitin 2022 tejkaluan shifrën 2 miliardë USD për buxhetin e shtetit, si burim i rëndësishëm për shpenzimet e buxhetit për shkolla, infrastrukturë, shërbime shëndetësore, është përmbushur me mirë menaxhimin, përgjegjshmërinë dhe përkushtimin e administratës doganore 24 orë në 7 ditë të javës.

Bashkëpunimi me partnerët, si Bashkimi Evropian, Organizata Botërore e Doganave, Banka Botërore dhe FMN, ka qenë në nivelet më të larta, çka ka ndikuar në rritjen e standardeve të shërbimeve në dogana. Kjo u confirmua dhe nga Banka Botërore në studimin e IFC- prill 2022, ku shkurtimi i kohës së zhdoganimit ishte me mbi 50 % si dhe Barometri i Ballkanit(gusht 2022), i cili confirmoi se Shqipëria ka procedurat më të shpejta doganore të import-eksporteve në rajon.

Dogana digjitale ishte misioni i realizuar i vitit 2022 dhe ja dolëm të ofrojmë 100


% të shërbimeve online duke shtuar edhe 4 aplikacione të reja, duke shkurtuar ndjeshëm kostot dhe kohën për bizneset dhe qytetarët që kanë përfituar nga lehtësitë doganore.

Brenda një viti, kemi autorizuar 9 Operatorë Ekonomikë të Autorizuar me lehtësi në eksporte dhe importe nëpërmjet Green Lane, të njohur edhe nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia e së shpejti dhe nga Kosova.

Nënshkrimi i Memorandumit për korridorin Blu me Italinë për lehtësimin e tregtisë në rrugë detare ishte një tjetër arritje, ndërkohë që në takimin e fundit të CEFTA në Bruksel u vendos për të vijuar procesin edhe me Bashkimin Evropian tashmë që janë hapur negociatat për anëtarësim. Kjo synon rritjen e standardeve të doganës me ato të BE-së.

Objektivi ynë për vitin 2023 është avancimi drejt dixhitalizimit dhe novacionit duke u përfshirë në projekte të rëndësishme me mbështetjen e DG Taxud dhe FMN-së, si projekti “Single Window” apo projekti “One-Stop-Shop”, që do të ofrojnë shërbimet në vetëm një dritare për biznesin, sistemi i ri i tranzitit ndërkombëtar, sistemi i integruar i menaxhimit të tarifave, përmirësimi infrastrukturës së degëve doganore etj.

# Misioni



Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar. Për këtë qëllim Autoritetet doganore synojnë mbrojtjen e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit; garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj, si dhe mbrojtje mjedisit në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera si edhe mbajtjen e ekuilibrit të duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.



**Doganat shqiptare, për përmbushjen e Misionit të saj, përcaktojnë parimet strategjike si më poshtë:**

- Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;

- Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare;

- Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme;

- Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave;

- Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit;



**Vizioni**

- Në harmoni të plotë me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së

- Një institucion publik modern, profesional, i paanshëm, i ndershëm, i besueshëm dhe i pakorruptuar

- Një partner mbështetës i komunitetit tregtar dhe ruajtës efikas i shoqërisë dhe zinxhirit të furnizimit



Administrata Doganore Shqiptare është në përpjekje të vazhdueshme për të përbushur me sukses misionet e saj, si atë fiskal, të lehtësimit të tregtisë, mbrojtës, si dhe të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në proceset e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

*Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore" i ndryshuar, Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është 1102 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror (DPD 464) dhe vendor (Degët Doganore 638).*

**ADSH ka në përbërje 1074 punonjës të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka 429 punonjës dhe degët doganore përbëhen nga 654 punonjës.**

**Në nivel qendror DPD është e organizuar në 4 (katër) departamente dhe drejtoritë pranë:**



<b>Zyrës së Drejtorit të Përgjithshem</b>	<b>51</b>
<b>Dp. Administrativ</b>	<b>63</b>
<b>Dp. Teknik</b>	<b>86</b>
<b>Dp. i Akcizës</b>	<b>35</b>
<b>Dp. Operativo Hetimor</b>	<b>194</b>

**Në nivel vendor është e organizuar në 18 degë doganore**

(Shkodër, Lezhë, Kukës, Bllatë, Tiranë, Rinas, Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Kapshticë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë dhe Tri Urat Përmet):

**Tokësore**

(Shkodër, Kukës, Bllatë, Tiranë, Elbasan, Qafë Thanë, Korçë, Kapshticë, Berat, Fier, Gjirokastër, Sarandë dhe Tri Urat)

**Detare**


(Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë) dhe

**Ajrore**

(Rinas, Aeroporti Kukës)

<b>Tokësore</b>	<b>13</b>
<b>Detare</b>	<b>4</b>
<b>Ajrore</b>	<b>2</b>






Tirana International Airport  
Nënë Tereza

*Aeroporti "Nënë Tereza"*



*Kalata porti i Vlorës*

## II. Organigrama e re-Administrata Doganore 2022-2023





GALAXY

IMO 7516773

*Porti Vlorë*

### III. Zhvillimet kryesore

#### Janar 2022

#### Dogana merr mbështetjen e Komisionit Evropian për programin 2021-2027

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me Gerassimos Thomas, Drejtor i Përgjithshëm për Taksat dhe Doganat në Komisionin Evropian, në Bruksel. Përfaqësuesi i KE, Thomas, mbështeti Doganën Shqiptare, e cila do të jetë pjesë e Programit të ri të DG TAXUD “Programi i Doganave” për periudhën 2021-2027, si vazhdimësi e programit “Dogana 2020”.



Nëpërmjet këtij Programi, Administratat Doganore Shqiptare do të vazhdojnë të punojë për t’iu përgjigjur sfidave të tilla si, mbrojtja e interesave financiare dhe ekonomike të BE-së, lehtësimin e tregtisë dhe bashkëpunimin, mbështetje e përgjithshme strategjike, forcimi i sigurisë, sidomos në Porte. Një tjetër prioritet i ADSH, në kuadër të rekomandimeve të Komisionit Evropian, është dhe zhvillimi i moduleve të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave (ITMS), që parashikon ndërtimin e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Tarifave plotësisht në përputhje me ITMS të BE-së.

## ■ Shkurt 2022

### SHBA dhuron skaner X për Doganën e Rinasi

Administratës Doganore Shqiptare iu dhurua nga Ambasada Amerikane në Tiranë, një skaner me rreze X, për kontrollin e bagazheve në aeroportin ndërkombëtar të Rinasis. Gjatë një ceremonie të organizuar me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, falënderoi Qeverinë e SHBA, që nëpërmjet Ambasadës kanë mbështetur ADSH në projekte të ndryshme.



## ■ Mars 2022

### Kryeministri takim me biznesin në Doganën e Tiranës

Kryeministri Edi Rama, Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilluan një bashkëbisedim me



importues, eksportues dhe përfaqësues të zinxhirit të furnizimit me produktet e shportës, në kushtet kur lufta në Ukrainë ka prekur zinxhirin e marrëdhënieve tregtare në Evropë e në botë.


Administrata Doganore është ndër institucionet që ka lehtësuar procedurat në ndihmë të sipërmarrjes import-eksport, ku është ulur ndjeshëm koha e përpunimit të deklarave doganore për t'i kursyer kohë dhe kosto biznesit, si dhe 34 shërbime ofrohen online aktualisht duke e bërë doganën moderne dhe të digjitalizuar.

Ndërkohë Kryeministri Rama informoi përfaqësuesit e biznesit se Ministria e Financave dhe Ekonomisë po punon për një instrument Garancie Sovrane, që do t'i shërbejë biznesit për të marr kredi, me shtetin si garantues, për kapital qarkullues për lëndët dhe e ushqimet bazë.

## ■ Mars 2022

### Vizitë e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Doganave

Sekretari i Përgjithshëm i OBD-së, z. Kunio Mikyriya dhe Drejtorit për Zhvillimin Rajonal për Rajonin e Evropës në WCO, Dashgin Aliyev, u pritën nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare, Genti Gazheli. Gjatë takimit pritës z. Mikyriya u informua për arritjet e Administratës Doganore në rritjen e cilësisë së shërbimeve, digjitalizimin e tyre, si dhe uljen e kostove, me qëllim përafrimin me standardet ndërkombëtare. Ndërsa kreu i OBD, z.Mikyriya vlerësoi progresin e bërë vitet e fundit nga ADSH, si dhe me futjen e teknologjive të reja e zhvillimin e burimeve njerëzore.





## Prill 2022

### Bashkëpunimi mes strukturave ligj zbatuese rrit sigurinë në Portin e Durrësit

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli dhe Ambasadorja e Francës në Tiranë, Elisabeth Barsacq, zhvilluan një vizitë në qendrën e Kontrollit të Kontejnerëve, në Portin e Durrësit, ku vlerësuan bashkëpunimin e strukturave që operojnë aty në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes së kufirit në këtë pikë të rëndësishme të hyrjes në vendin tonë.



## Maj 2022

### Dogana merr asistencë nga HMRC

Administratës Doganore Shqiptare iu dhurua nga zyra e përfaqësimit të HM Revenue & Customs në Ambasadën Britanike, në Tiranë, 17 makineri të numërimit të vlerave monetare (cash).

Gjatë një ceremonie të organizuar me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i



Doganave, Genti Gazheli, falënderoi autoritetet britanike, që nëpërmjet Ambasadës kanë mbështetur ADSH në projekte të ndryshme. Zv. Ambasadorja e UK, në Tiranë, Mia Marzouk, theksoi se ndërveprimi ndërkombëtar është thelbësor në zbulimin e mashtrimeve dhe pastrimin e parave, por sipas saj, bashkëpunimi do të vazhdojë në një mënyrë produktive dhe të frytshme me Dogana Shqiptare. Oficeri Ndërlidhës i HMRC, Emma Harper, vlerësoi punën e bërë nga ADSH, dhe u shpreh, se krimi nuk njihet kufij dhe për këtë arsye bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor.

## ■ Maj 2022

### Banka Botërore vlerëson projektet për lehtësimin e tregtisë

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli, zhvilloi një takim me Misionin e Bankës Botërore të kryesuar nga z. Alberto Criscuolo, në kuadër të projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor dhe nismën “Ballkan i hapur.

Në fjalën e tij Z. Gazheli vlerësoi lehtësitë që ofron projekti në dhënien e certifikatave, licencave apo autorizimeve për subjektet që kryejnë import, eksport dhe transit në Shqipëri që e kanë të domosdoshëm këto dokumente.

Lidhur me projektin e ri për Tranzitin e Kompjuterizuar Ndërkombëtar (New Computerized Transit System (NCTS), z. Gazheli theksoi se do ta vendosi Shqipërinë apo Pikat kufitare Doganore Shqiptare në të njëjtin nivel me ato Europiane për nga thjeshtëzimi i procedurave doganore.

Projekti i tretë me Bankën Botërore është realizimi i Pikës së Përbashkët Doganore Maqedoninë e Veriut atë Qafë Thanës për realizimin e procedurës me një ndalesë “One Stop Shop” me synim lehtësimin e procedurave doganore në import dhe eksport nga të dy anët e kufirit.

## ■ Qershor 2022

### Kryeministri Rama vizitë në degën doganore të Qafë-Thanës

Kryeministri Edi Rama dhe Ministrja e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj vizituan Degën Doganore të Qafë Thanës ku u pritën nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli. Në fjalën e tij Kryeministri u shpreh se do të vijojnë lehtësimet për të gjithë bizneset që kryejnë eksport-import ndërmjet vendeve të rajonit.

“Nisma e Ballkanit të Hapur ka sjellë përfitime dhe rezultate konkrete në drejtim të lehtësimit të tregtisë dhe njohjes reciproke të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar(AEO):

- Më pak kontrolle fizike dhe të dokumentacionit në krahasim me operatorët ekonomikë të tjerë;
- Trajtim prioritar dhe njoftim prioritar në rast seleksionimi për kontroll doganor;
- Mundësi për të kërkuar hapësira specifike përveç zyrave doganore për kontrollet e doganës”.



## Qershor 2022


### Gazheli në Open Ballkan

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori pjesë në takimin teknik u zhvillua në kuadër të Open Ballkan në Ohër të Maqedonisë së Veriut, me 7-8 Qershor. Gjatë këtij takimi, i cili u drejtua nga Ministrat e Bujqësisë, të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, ishin të pranishëm drejtorët e doganave si dhe AKU. Drejtori i Doganës Shqiptare, Gazheli theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis vendeve në kuadër të lehtësimit të tregtisë, njohjen e përbashkët të AEO-ve dhe intensifikimin në të ardhmen në kuadër të Open Ballkan. Në kuadër të Open Ballkan, që u mbajt në Ohër të Maqedonisë së Veriut, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli, zhvilloi një takim me drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Serbisë, z. Branko Radujko, ku diskutuan mbi bashkëpunimin mes dy administratave.



### Drejtori Përgjithshëm i Doganave, Gazheli merr pjesë në mbledhjen e Këshillit të OBD

Drejtori i Përgjithshëm e Doganave, Genti Gazheli, morri pjesë në mbledhjen e Sesioneve 139/140 të Këshillit të Organizatës Botërore të Doganave, organi më i lartë vendimmarrës i Organizatës. Gjatë këtij takimi që u zhvillua në selinë e OBD-së, në



Bruksel, në datat 23-25 qershor 2022, z.Gazheli zhvilloi një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të OBD, Kunoi Mikuriya, si dhe me Drejtorët e Përgjithshëm të Doganave të Ballkanit Perëndimor, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut.

### Dogana Shqiptare merr vlerësimin pozitiv nga CEFTA për Validimin e AEO-ve

Grupi i Validimit të CEFTA, nën mbikëqyrjen e DG TAXUD të Bashkimit European, në fund të vlerësimit disa ditor në Tiranë, konkludoi se programi i Doganave Shqiptare për Operatorët Ekonomike të Autorizuar i ka plotësuar kriteret sipas të gjitha standardeve të Protokollit përkatës duke marrë opinionin pozitiv.



### Shqipëri-Kosovë, nënshkruhet Memorandumi për njohjen reciproke të plumbçeve

Në kuadër të mbledhjes së radhës së përbashkët të Qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës, dhe të thellimit të bashkëpunimit në fushën doganore, në Morinë, u nënshkrua Protokollin i Bashkëpunimit mes Administratave Doganore për njohjen reciproke të plumbçeve. Nënshkrimi i Memorandumit u bë nga Drejtorët e Përgjithshëm të Doganave të Shqipërisë z. Genti Gazheli dhe të Kosovës z. Agron Llugaliu. Z.Gazheli theksoi se Memorandumi është në vijim të Marrëveshjeve dhe Protokolleve të bashkëpunimit në fushën doganore dhe pritet të krijojë lehtësira për biznesin në kalimin transit të mallrave. Njohja e plumbçeve nga dy administratat doganore ka zvogëluar kohën e qëndrimit të mjeteve në pikën e kalimit Morinë/Vërnice.



## Dogana merr vlerësimet e biznesit për lehtësimin e tregtisë

Me ftesë të Dhomës Amerikane të Tregtisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave diskutoi në një forum biznesi aspektet kryesore të lehtësimit të procedurave doganore, uljes së kohës së zhdoganimit, përmirësimin e klimës së biznesit dhe rezultatet e pyetësorit për raportet mes biznesit dhe doganave. Dogana është përfshirë në një proces të thellimit dhe zgjerimit të digjitalizimit.



Bizneset deklarojnë në sistemin informatik të doganës pa shkresa (“paperless”), marrin autorizime/lehtësime/vërtetime online nëpërmjet Platformës e-Albania, nuk paraqiten më pranë sporteleve/zyrave të autoritetit doganor për depozitim kërkesash/dokumentesh, proces i cili merrte minimalisht 2 ditë, një për hyrjen e një për daljen e shkresës. Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofron 34 shërbime online dhe 4 aplikacione (nga muaji Mars 2022 “Statusi i deklaratës tranzit”, “Statusi deklaratës import-eksport”, “Gjendjen e llogarisë parapaguese” si dhe “Konfirmimin e pagesave të kryera nga subjektet në llogaritë e doganës”), ndërkohë që brenda vitit të gjitha shërbimet do të jenë online.



*Dogana Morinë Kukes*

## Korrik 2022

### Forumi i Konektivitetit në Selanik për lehtësimin e procedurave doganore

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z.Genti Gazheli mori pjesë në Forumin e Konektivitetit në Selanik, një aktivitet i rëndësishëm mbi bashkëpunimin mes Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të Komisionit Evropian, Ministrive të Transportit dhe Administratave Doganore. Gjatë këtij Forumi, z. Gazheli zhvilloi takime dypalëshe me Administratat



Doganore të Italisë dhe Greqisë, ku u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit, shkëmbimit e informacioneve dhe lehtësimin e procedurave doganore.

## Gusht 2022

### Barometri i Ballkanit: Shqipëria, me procedurat më të shpejta doganore


“Balkan Barometer Business Opinion 2022”, realizuar nga Regional Cooperation Council(RCC) me financimin e Bashkimit Evropian (BE) vlerëson progresin e procedurave në shërbim të biznesit të Doganave Shqiptare. Edicioni 2022 i Barometrit të Ballkanit-Regional Cooperation Council i Balkan Barometer Business Opinion 2022 (rcc.int), vlerëson perceptimet e biznesit nëpërmjet një pyetësoi me 177 pyetje drejtuar 1203 përfaqësuesve të biznesit, edhe sa i përket procedurave doganore për importet dhe eksportet.

Sipas Barometrit, “në rajon Shqipëria duket që ka procedurat më të shpejta doganore të importeve në dogana me më pak se dy ditë(për më shumë se 50 % të importuesve) ndërkohë që më shumë kohë, mbi 5 ditë, kërkohet në doganat e Bosnje-Hercegovinës



dhe Maqedonisë së veriut( respektivisht 14% dhe 10% e të intervistuarve)”. Sipas Barometrit, Shqipëria ka ndër procedurat më të shpejta doganore edhe për eksportet në më pak se dy ditë, ndërkohë që për vendet e tjera koha doganore e çlirimit të mallrave për eksport është 3-5 ditë.

Nëse keni importuar gjatë 12 muajve të fundit cili është numri mesatar i ditëve për procedurat doganore?



## Shtator 2022

### Bashkimi Evropian dhe GIZ mbështesin Administratën Doganore dhe AKU

Drejtor i Përgjithshëm i i Doganave z. Genti Gazheli mori pjesë në takimin rajonal mbi “Fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratave Doganore dhe Agjencive përgjegjëse për sektorin Fitosanitar në kuadrin e programit OEA”, mbajtur në Vlorë, me datë 21 shtator 2022. Takimi rajonal u organizua në kuadër të projektit “Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal”, i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe i mbështetur nga



Komisioni Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Ky takim kishte si qëllim prodhimin e një këndvështrimi të përbashkët mbi situatën aktuale dhe identifikimin e prioriteteve të përbashkëta për të përmirësuar më tej efikasitetin dhe transparencën e të dy Autoriteteve me interes për botën e biznesit dhe Rajonin.

## ■ Shtator 2022

### Korsitë Blu mes CEFTA- BE-së për të lehtësuar trafikun detar

Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Doganore të Shqipërisë, Genti Gazheli, dhe Marcello Minenna, Drejtor i Agjencisë së Akcizave, Doganave dhe Monopoleve të Italisë, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet këtyre institucioneve në Romë. Sistemi SEED për shkëmbimin elektronik të të dhënave është thelbi i nismës, i cili do të përshpejtojë procedurat doganore, formalitetet dhe kontrollet doganore. Kjo mundësi u shfrytëzua për të diskutuar mbi zhvillimin e ardhshëm të nismës Korsitë Blu (Blue Lanes) dhe marrëdhëniet tregtare në zonën e Detit Adriatik.



## ■ Tetor 2022

### Bruksel, Drejt "Bashkimit Doganor" me BE

Shqipëria mbetet e angazhuar për të ecur përpara në reformat administrative dhe institucionale të kërkuara dhe përafrimin e legjislacionit me atë të BE.

Komisioni Evropian dhe delegacioni shqiptar i kryesuar nga Zëvendësministrja dhe Negociatorja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. Vasilika Vjero zhvilluan në Bruksel, takimin shpjegues për Kapitullin 29 "Bashkimi Doganor".



Progresi i vendit në Kapitullin 29 "Bashkimi Doganor" është vlerësuar në raportin e KE-së për Shqipërinë për vitin 2022, duke theksuar punën përgatitore për zhvillimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit, zbatimin e programit të operatorit të autorizuar ekonomik (OAE), vlefshmërinë e suksesshme të standardeve të sigurisë dhe sigurisë në përputhje me Protokollin Shtesë 5 të CEFTA-s, zbatimin e rregullave kalimtare të origjinës në pan - Zona Euro-Mesdhetare dhe fuqizimi, dixhitalizimi i shërbimeve, etj.

## Washington D.C- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave në takimet vjetore FMN-BB

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z.Genti Gazheli, ishte për herë të parë pjesëmarrës në delegacionin e lartë të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë, që po merr pjesë në mbledhjen Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore. Në këtë forum të nivelit të lartë u diskutuan zhvillimet kryesore në ekonominë botërore, ku fokus i veçantë janë sfidat aktuale të inflacionit, konsolidimit fiskal, ndryshimeve klimaterike, krizës energjetike dhe të ushqimeve.



## ■ Nentor 2022

### Statusi OEA, lehtësi për biznesin në gjithë rajonin

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, dhe Elisabeth Brasacq, Ambasadore e Francës në Tiranë,



zhvilluan një vizitë në kompaninë “Marlotex”, në Berat, të cilës iu dorëzua dhe certifikata e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (AEO). Kompania “Marlotex” e krijuar në vitin 2005 në Berat, është investim shqiptaro-francez në fushën e industrisë tekstile. Ajo ka të punësuar 250 punëtorë, ndërsa modeli ekonomik i saj është i bazuar vetëm në eksport. Pasi pa nga afër të gjithë proceseve të punës, Ministri Ibrahimaj u shpreh se nismat e qeverisë janë në funksion të krijimit të një klime të favorshme të biznesit.

## ■ Nentor 2022

### Bashkëpunimi Rajonal me homologët dhe rritja e standardeve



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli mori pjesë në konferencën e Shoqatës Rajonale të Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (OEA) me titull “Përmirësimi i programeve OEA në Rajon - Përfaqimi i kulturës së të dhënave digjitale për përmirësimet vazhdueshme, transparencë të përmirësuar, partneritet dhe reziliencë më të fortë”, zhvilluar në Beograd në datat 3-4 Nëntor 2022.



## Dhjetor 2022

### Indeksi Besimit të Biznesit te doganat në nivelin më të lartë

Shërbimet Doganore marrin vlerësimet pozitive nga biznesi. Indeksi i Besimit të Biznesit i Dhomës Amerikane të Tregtisë, vlerësoi Doganat me nivelin më të lartë të pikëve ndër agjencitë publike me mbi 62.5 përqind. Në prezantimin e Indeksit të Biznesit, marrëdhëniet e Biznesit me Doganat kanë shënuar përmirësim për vitin 2021, duke u vlerësuar një nga indekset më të larta për raportet biznes-institucione publike.



## ■ Dhjetor 2022

### CEFTA, doganat pjesë e korridoreve të gjelbër me BE-në

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori merr pjesë në konferencën qendrore të CEFTA, “ Një hap drejt Tregut Unik të BE-së”, që u mbajt më 9 dhjetor 2022, ku Administratat doganore të Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë dhe Malit të Zi do të nënshkruajnë Memorandume Mirëkuptimi, duke zgjeruar më tej Korridoret e Gjelbër CEFTA-TCT me Bashkimin Evropian. Këtë konferencë e përshëndetën dhe Komisioneri për Zgjerimin dhe Fqinjësinë e Mirë, në KE, Oliver Varhelyi dhe drejtorja në Detyrë e departamentit të Zgjerimi, Michela Matuella.




## IV. Performanca e të ardhurave doganore

Të ardhurat nga doganat për vitin 2022 arritën shifrën rekord historik prej 223.3 miliardë lekë ose mbi 2 miliardë dollarë.


Në krahasim me vitin 2021 janë realizuar rreth 30.2 Mld lek me shume (rreth 300 Mln \$ me shume).

Duhet vlerësuar se viti 2022 ka realizimin më të lartë që prej vitit 2013, megjithëse i ndikuar nga situata e një krize të zgjatur:






**Taksa Doganore, +989 Mln lek një shumë që vjen si pasojë e rritjes së importeve nga Kina**




Akciza, ne total +1,9 Mld lek që ka ardhur përgjithësisht nga rritja e akcizës së cigares dhe rritja e sasisë së konsumit me rreth 191 ton, me një rezultante prej rreth 2,3 Mld lek, Gazi me +500 Mln, Birra me rreth +120 mln, Pije alkoolike me +50 mln si dhe indeksi i akcizës me 3.3%. Negativisht në akcizë ka ndikuar Karburanti i importit me rreth -1,2 Mld lek që vijnë si pasojë e rënies së konsumit me rreth 57,000 ton, e ndikuar drejtpërdrejt kjo nga situata globale e lufta në Ukraine dhe embargos Ruse.




TVSH, ne total, T.V.SH-ja krahasuar me dymbëdhjetë-mujorin 2021 ka dhënë rreth 24 Mld lek më shumë, e stimuluar kryesisht nga:

- +5,3 Mld lek rritje e çmimit të karburantit dhe ndikimi i saj i drejtpërdrejt në TVSH.
- +5,1 Mld lek rritje e importit të energjisë elektrike.
- +3,7 Mld lek rritje nga Mallrat e konsumit të përgjithshëm, etj....
- +3,1 Mld lek rritje nga importi i Metaleve Baze
- +1,5 Mld lek rritje nga importi i Gazit të lëngshëm
- +800 Mln lek te ardhura nga rritja importi i Cigares etj.



**Renta**, +1,8 Mld lek për shkak të efektit të rritjes së çmimit të bursës me rreth +70%. Rritja është 1,1 Mld për naftën bruto dhe 600 Mln për mineraret e tjera, megjithëse janë eksportuar 20,000 ton naftë bruto me pak dhe 410,000 ton minerare të tjera me pak.



## V. Zbatimi ligjit

### Lufta ndaj trafikeve të paligjshme




Si rezultat i shtimit të kontrolleve me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e trafikimit të lëndëve narkotike, bazuar edhe në analizën e riskut, në portin e Durrësit janë bërë 3 kapje të lëndës narkotike kokainë me origjinë nga Amerika e Jugut. Në pikat e kalimit kufitar Rinas dhe Kakavijë janë zbuluar dhe sekuestruar gjatë kontrolleve në vijën e dytë, 2 armë dhe 625 cp municione.


Kokainë	Kanabis	Armë	Klandestinë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• 139 kg</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 193 kg</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 armë</li> <li>• 625 municione</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 99 persona</li> </ul>

### Rastet e kapjeve/mosdeklarimeve të Cash-it në P.K.K.


Në vitin 2022, gjatë kontrolleve të ushtruara nga Administrata Doganore në Pikat e Kalimit Kufitar janë konstatuar në total 37 raste të kapjeve/mos deklarimeve të vlerave monetare. Nga këto, numri më i madh është kryer në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” (14 raste), me shuma të cilat variojnë mesatarisht nga 14,000 GBP deri në 25,000 EUR.

Më poshtë janë të ndara sipas pikave të kalimit kufitar tokësore/detare/ajrore:

2022			
<b>Raste</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>17</b>
<b>Vlera</b>	98.475GBP 175.830 EUR	14.915 GBP 801.010 EUR	1.850.600 ALL 51.400 GBP 324.509 EUR

**Numri i kapjeve sipas monedhës**

**Rastet e kapjeve të Cash-it sipas hyrje/daljeve**

Numrin më të madh të rasteve për vitin 2022, e përfaqësojnë kapjet në hyrje të P.K.K. me 28 raste, dhe kapjet në dalje me 9 raste.


**Mbrojtja e Pronësisë Intelektuale**

DMPI, ka trajtuar 147 aplikime për veprim të paraqitura nga mbajtësit e të drejtës të pronësisë intelektuale.

Gjatë vitit 2022, Administrata Doganore si institucion ligjzbatues përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, ka pezulluar për çlirimin në qarkullim të lirë mallrat si më poshtë vijon:


- Sipas procedures ex-officio

Artikuj	MARKA TREGTARE	Sasia (copë/ml)
syprina këpucësh	Timberland	3600

Mallrat janë çliruar nga Administrata Doganore, për mos reagim nga mbajtësit e së drejtës brenda afateve ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë,

- Me një aplikim për veprim të miratuar pranë DPD-së

Artikuj	MARKA TREGTARE	Sasia (copë/ml)
portofolë	Lv	500
portofolë	Gucci	400
portofolë	Tommy Hilfiger	100
Ilaç për miza	H10	1140



### Shkëmbimi i informacionit dhe inteligjenca doganore

Është rritur bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me qëllim goditjen e shkeljeve doganore, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha doganat homologe, në veçanti me ato fqinje. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka vijuar koordinimi dhe bashkëpunimi i suksesshëm me Qendrën për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, SELEC në luftën e përbashkët kundër krimit ndërkufitar.

Suksesi i punës së Departamentit Operativ Hetimor në ADSH është pasqyruar edhe në faqen e parë të botimit të revistës HERALD për vitin 2022 të RILO ECE të Organizatës Botërore të Doganave. Në kuadër të punës dhe të rezultateve të larta të Departamentit Operativ Hetimor, ADSH u përzgjedh si pjesëmarrëse në “Hot Zonë Prioritization Forum” organizuar pranë OBD-së në kuadër, për të ndarë eksperiencat e saj në luftën kundër trafikëve të paligjshme.

Risi për këtë vit ishte dhe marrja e aksesit në sistemin SIENA të EUROPOL, si një mënyrë për shkëmbimin e informacionit me agjensitë e tjera ligjzbatuese ndërkombëtare. Pesë zyrtarë të autoritetit doganor u certifikuan nga EUROPOL si përdorues dhe trajnerë të kësaj platforme.

Gjithashtu një tjetër sistem me shumë vlerë për ADSH, është edhe nCEN (National Customs Enforcement Network). Mirë-funksionimi i kësaj baze të të dhënave të rrjetit

kombëtar të zbatimit doganor rezultoi në një rritje të regjistrimit të kapjeve duke mbështetur kryerjen e analizave dhe raportimeve.

Në kuadër të përmbushjes së misionit të departamentit, qasja në sistemet si SEED+ dhe ndërtimi i profileve të riskut të përbashkëta rajonale kanë ndihmuar për ruajtjen e ekuilibrit midis lehtësimit të tregtisë së lirë dhe kontrolleve doganore të mallrave. Në vijim të kësaj nisme, vlen të përmendet si një hap shumë i rëndësishëm edhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mbi shkëmbimin elektronik të të dhënave me Administratën Doganore Italianë, në muajin Shtator 2022.

### Lufta ndaj kontrabandës:


Drejtoria e Antikontrabandës, si pjesë përbërëse e DOH, bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda DPD dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, në identifikimin e individëve, personave fizikë dhe juridikë, që zhvillojnë në mënyrë të paligjshme aktivitetin e tyre, me synim zbulimin, frenimin e kontrabandës, informalitetit dhe kundërvajtjeve administrative.

Gjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Antikontrabandës, janë realizuar 2,324 kontrolle, nga të cilat 189 ose rreth 8.13% kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, janë zbuluar 30 raste me shkelje doganore, me një vlerë totale: 6,268,265 Lekë. Efektiviteti i kontrolleve me shkelje për periudhën Janar - Dhjetor 2022 rezulton në masën 15.87%.

Kontrollet e plota, penaltetet dhe efektiviteti Janar - Dhjetor 2022,  
pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Viti	Nr. kontrolleve në rregull	Nr. kontrolleve me penaltet	Nr. kontrolleve të plota	Efektiviteti
2022	159	30	189	15.87%



Pasqyruar të dhënat:



Grupet e kontrollit të Antikontrabandës/Tokësore, kanë kryer kontrole në të gjithë territorin doganor dhe akset rrugore, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme.

Gjatë kontrolleve të ushtruara, numri më i lartë i rasteve me shkelje, të konstatuara nga Drejtoria e Antikontrabandës, në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera, rezulton në zonat doganore: Tiranë dhe Durrës.

Pasqyruar numri i rasteve me shkelje dhe % e tyre, sipas Zonave Doganore 2022:



Janar - Dhjetor 2022	
Anije Tregtare (kontrolle mallrash)	1,878
Furnizime Bordi (në mjetet detare)	1,368

Si rezultat i kontrolleve të përbashkëta në Portin e Durrësit, Antikontrabanda Detare, në bashkëpunim me strukturat doganore, Policinë Kufitare, Rojën Bregdetare, si dhe organeve të tjera ligjzbatuese, kanë zbuluar: 1 rast me drogë dhe 2 raste kontrabandë karburanti, të cilat janë bllokuar, duke iu kaluar për procedura të mëtejshme, organeve përkatëse.


Hetimit Doganor

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 kanë qenë në proces hetimi çështje me karakter sensitiv apo kërkesa për verifikim nga të cilat, janë trajtuar 4 094 çështje dhe mbyllur 242 çështje.

Përshkrimi i çështjeve më të rëndësishme:

### 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022

Drejtorja e Hetimit mban edhe korrespondencën me Strukturat e Policisë së Shtetit me Policinë dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të cilat kërkojnë informacion për subjekte tregtare, apo persona fizikë të cilët janë objekt i ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.



Vazhdojnë verifikimet/hetimet për 250 automjete, pjesë e 2214 automjeteve të cilat janë vit prodhimi nga 1997-2003, të zhdoganuara, por të refuzuara për targim për shkak të mosplotësimit të kushteve të kategorisë mjedisore të dërguara nga Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



## VI. Lehtësimi i Procedurave Doganore

Administrata Doganore funksionon prej vitesh pa shkresa (paperless) duke shkurtuar koston dhe kohën e shërbimit për qytetarët dhe bizneset. Orientimi i konceptit të Doganës Dixhitale- ‘Digital Customs’ është objektiv i realizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për përdorimin e sistemeve dixhitale në mbledhjen e detyrimeve doganore, kontrollin e fluksit të hyrje-daljeve të mallrave, njerëzve, lëvizjes së parave, për të siguruar tregtinë ndërkufitare.

Qytetarët dhe bizneset mund të marrin shërbimet online nëpërmjet portalit e-Albania me shërbimet e dedikuara doganore dhe për pasojë;

- “Dixhitalizimi” ka modernizuar sistemin doganor,
- “Dixhitalizimi” ka ofruar më shumë cilësi shërbimi dhe ulje të kostove dhe kohës për bizneset,
- “Dixhitalizimi” ka mundësuar përafrimin e standardeve shqiptare me ato të Shteteve të Bashkimit Evropian.
- “Dixhitalizimi” në Administratën Doganore ka sjellë si risi zvogëlimin e kohës dhe koston të përpunimit të deklaratës doganore.

Gjatë vitit 2022 në Administratën Doganore Shqiptare u ofruan online 43 shërbime dhe 4 aplikacione. Përmes portalit e-Albania për vitin 2022 u realizuan 10,055 aplikime për vendime të favorshme.

Drejtoria Teknike e Akcizës është angazhuar në:

- Janë lëshuar **114 autorizime për përfitimin e nivelit të diferencuar të akcizës.**
- Janë lëshuar **44 autorizime të përjashtimit nga akciza Trupin Diplomatik** në bazë të kuotave të miratuara nga Ministria e Jashtme Përjashtimet nga akciza për Trupin Diplomatik.
- **Krijimi i kodit shtesë për 1241** përjashtime nga akciza të karburantit të anijeve të peshkimit.
- **Janë regjistruar 727 garanci** në sistemin informatik doganor të dërguara nga degët doganore për depozituesit e miratuar si dhe garancitë për pullat fiskale.
- Aplikime në sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes së pullave SICPATRACE

**Porosi pulla fiskale – 2256 porosi të miratuara**

**Shtesë furnitori- 237 aplikime**

**Krijim profili- 149 aplikime**



WWW.BASTRUCKS.COM

**SKYNET**  
WORLDWIDE EXPRESS

email: info@skynet.al

STOP  
DODANI

AB-677CL

## VI.1. Digitalizimi i proceduarve doganore


Për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022 janë realizuar përmes platformës e-albania;  
- 644 Aplikime

Aplikim për makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë (pesëqind milionë) lekë, të cilat nuk janë për shitje	73
Aplikim për makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit	83
Aplikim për Trajtim Tarifor Favorizues: mallra industriale	9
Autorizim Informacion i Detyrueshëm Tarifor	6 dhe 4 ne proces shqyrtimi
Autorizim përjashtimi nga detyrimet doganore	473

Janë menaxhuar në sistemin elektronik doganor AW rreth 180 raste subjekte të rindërtimit.

## VI.2. Autorizimet për magazina fiskale

Në total, gjatë 2022 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë dhënë në total 43 autorizime për magazina fiskale.



### Karburantet

- Gjatë vitit 2022 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është dhënë 1 autorizim për magazinë fiskale stokimi, karburant
- Janë dhënë 17 autorizime për magazinë fiskale pritës të regjistruar, anije peshkimi.

### Alkool

- Gjatë vitit 2022 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është dhënë 1 autorizim për magazinë fiskale stokimi, birra.
- Janë dhënë 8 autorizime për magazinë fiskale prodhimi, verë.
- Janë dhënë 3 autorizime magazinë fiskale prodhimi, birra.
- Është dhënë 1 autorizim magazinë fiskale prodhimi, gin.

### Të tjera

- Është dhënë 1 autorizim magazinë fiskale prodhimi, kafeje.
- Është dhënë 1 autorizim magazinë fiskale prodhimi, zhavorr.
- Janë dhënë 10 autorizime për magazinë fiskale pritës të regjistruar, kafeje.



## VI.3. Inovacioni teknologjik

ADSH në bashkëpunim me AKSHI dhe UNCTAD ka realizuar testimin dhe implementimin e upgradit të ri të sistemit asycuda ëorld.

Administrata Doganore nga muaji Mars 2022 ofron shërbime të reja për biznesin nëpërmjet aplikacionit E-albania si “Deklarata e thjeshtuar”, “Statusi i deklaratës tranzit”, “Statusi i deklaratës import-eksport”, “Gjendjen e llogarisë parapraguese” si dhe “Konfirmimin e pagesave të kryera nga subjektet në llogaritë e doganës”.

## VI.4. Autorizohen 9 Operatorë Ekonomikë (AEO)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me vizionin për modernizimin e shërbimeve nëpërmjet digitalizimit, në kuadër të thjeshtimit të procedurave dhe lehtësimeve doganore, ofron shërbimin për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA). Këtë lehtësi e përfitojnë kryesisht operatorët ekonomikë që kanë besueshmërinë e duhur ndaj autoriteteve fiskale, aftësi paguese financiare, sisteme efikase menaxhimi, sigurie, auditimi, politika të qarta personeli dhe operojnë me partnerë seriozë në të gjithë zinxhirin e veprimtarisë së tyre.

Përfitimet e këtij statusi sjellin një trajtim të favorshëm dhe prioritar në vlerësim të riskut dhe kontrolleve doganore, si dhe akses në përdorimin e të gjitha thjeshtimeve dhe lehtësive që parashikon legjislati doganor.


Njohja reciproke e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar nga autoritetet doganore në të gjitha vendet e rajonit (CEFTA) konsiderohet një mundësi e madhe për zhvillimin e biznesit në tregun rajonal dhe në të ardhmen më gjerë në atë europian.

Në një treg të hapur për tregtinë ndërkombëtare, ky status është një prezantim dinjitoz i biznesit tuaj dhe i mundëson mbajtësit (përfituesit) përdorimin e logos (AEO) në dokumentacionin tregtar duke i siguruar një përfaqësim dinjitoz tek partnerët ndërkombëtarë në biznes apo avantazh ndërkombëtar.

Informimi dhe sensibilizimi i subjekteve ka qenë në fokus të sektorit me qëllim ndërgjegjësimin e tyre rreth përfitimeve që sjell statusi OEA dhe rritjen e numrit të aplikimeve e certifikatave të lëshuara.

- Takime informuese në biznese që potencialisht i plotësojnë kriteret e kërkuara;
- Njoftime të Dhomave të Tregtisë (qendrore dhe lokale) si dhe shoqatave të biznesit;
- Ftesa individuale drejtuar bizneseve;
- Trajnime me përfaqësues të bizneseve

### Statistika AEO



## VI.5. Tarifa

Hartimi, adoptimi dhe zbatimi i ndryshimeve të Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave në kuadër të standardizimit të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2023.

Sistemi i Menaxhimit të Tarifës së Integruar (ITMS), në kuadër të Planit Kombëtar për Koordinimin e Politikës Tregtare dhe Lehtësimin e Tregtisë 2021 – 2023.

1. Implementimi i ITMS është në fazën e krijimit të moduleve në Sistem, të cilat po kryen nga Kompania SIVCO në bashkëpunim me ekspertët e AKSHI.

Aktualisht janë implementuar 6 module dhe po punohet për dy modulet e fundit.

Parashikohet që në fund të muajit janar 2023, modulet të jenë gati për testim.

2. Realizimi i ndërveprimit me ASYCUDA për implementimin e ITMS në bashkëpunim me ekspertët e UNCTAD, kryerja e testeve në sistem dhe trajnimi i stafit.

## VI.6. Origjina

Operatorët ekonomikë dhe biznesi mund të zgjedhin të zbatojnë rregullat e reja kalimtare të origjinës në tregtinë me disa vende që aderohet në Konventën Rajonale pan-Euro-Mesdhetare të rregullave të origjinës preferenciale. Ky është një grup i ri rregullash të miratuara përkohësisht nga disa vende, në pritje të përfundimit të procesit të ndryshimit të Konventës PEM. Ato janë aktualisht të zbatueshme në baza dypalëshe dhe vullnetare në marrëdhëniet tregtare midis BE-së, Shqipërisë (nga 1 shtator 2021) dhe nga 2022 edhe me vendet EFTA si Norvegjia, Zvicra, Islanda dhe Lihtenshtejni. Rregullat e reja paraqesin mundësi për bizneset sepse e bëjnë menaxhimin e rregullave të origjinës dhe aksesin në preferencat tarifore më të thjeshtë dhe më fleksibël. Shqipëria dhe vendet EFTA kanë rënë dakord ta shtrijnë kumulimin e origjinës edhe për tekstilet.

Përgjatë vitit 2022 janë miratuar 7 kërkesa të Operatorëve Ekonomikë për miratimin e procedurës së thjeshtëzuar për lëshimin e provave të origjinës duke i pajisur ata me Autorizim të Statusit “Eksportues i Miratuar”.



Pjesëmarrje në takimet e dy Grupeve të Punës së Projektit e-PoC në lidhje me lëshimin elektronik të provave të origjinës, certifikatave EUR.1 në zonën pan-Euro-Mesdhetare (PEM) dhe Komitetit të Përbashkët PEM dhe të Grupeve të Punës së Konventës PEM.

Trajnime në lidhje me rregullat e origjinës preferenciale PEM dhe rregullat trazitore me vendet CEFTA si dhe rregullat e origjinës në tregtinë me Mbretërinë e Bashkuar.

Prioritet për në vitin 2023 është zbatimi i rregullave të reja kalimtare të origjinës edhe me vendet CEFTA.

### VI.7. Laboratori Doganor

Gjatë vitit 2022 janë analizuar 3087 mallra ose rreth 26 033 tregues analitikë, nga të cilat 2 130 (70 %) mostra janë mallra akcize (produkte hidrokarburike e alkoolike) ose rreth 21 519 tregues analitikë. 3 008 Certifikata të Klasifikimit Tarifor, nga të cilat 276 me ndryshim klasifikimi tarifor dhe 101 Fletë Analiza.



Pjesëmarrje në 10 Teste Zotësie ndërkombëtare me rezultate shumë të mira.

## VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar

ADSH, si pjesë e rrjetit ndërkombëtar doganor dhe të agjencive ligjzbatuese, përgjatë vitit 2022 është përfshirë intensivisht për rritjen e rolit dhe pranisë së saj ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të strukturave të saj në aktivitetet që synojnë mbrojtjen e interesave ekonomike dhe të sigurisë kombëtare dhe rritjen e kapaciteteve teknike e administrative dhe që konsistojnë kryesisht në:

- Pjesëmarrjen dhe menaxhimin e aktivitetet e projekteve të bashkëpunimit administrativ dhe asistencës teknike të financuara nga Bashkimi Evropian dhe nga organizma të tjera ndërkombëtare; (Binjakëzim BE, ITMS, Comobilion, Horizon 2020 + BB – SË, NCTS, Qafë-Thanë, Hunter – Border Force, EXBS)
- Pjesëmarrjen në nisma ndërkombëtare (përfshirë ato rajonale) dhe programe bashkëpunimi me struktura të ngjashme evropiane dhe ndërkombëtare (OBD, DG. TAXUD, SELEC, OLAF, CEFTA, Open Balkan);
- Përfaqësimin ndërkombëtar të institucionit (takimet dy/shumë-palëshe, TR, GR, KS, Balkan 6, CEFTA Week);

### VII.1. Projektet me Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore

Është mundësuar/koordinuar pjesëmarrja në aktivitetet në kuadër të projekteve ku DPD është përfituese:

Projekti (rajonal) i Bankës Botërore “Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor (WBTTFP)”

Në kuadër të këtij Projekti me vlerë 17,600,000 Euro (ose 20,000,000 USD), nga të cilat Dogana përfiton komponentë me vlerë ~US \$12 milion) që përfshijnë:

#### ▪ Sportelin e Vetëm Kombëtar (National Single Window)

Single Window është platformë e mandatuar nga Qeveria dhe që lejon paraqitjen e informacionit për të përmbushur kërkesat rregullatore midis operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve qeveritare. Single Window mundëson komunikimin elektronik midis autoriteteve doganore dhe gjithë institucioneve kombëtare që lëshojnë leje, licenca, autorizime të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e procedurave doganore, duke sjell uljen e kohës së zhdoganimit, uljen e kostove për bizneset, lehtësi dhe transparencë.

#### ▪ Sistemin e Ri të Kompjuterizuar të Transiti – Platforma NCTS



Në këtë kuadër është realizuar:

- Analizimi i legjislacionit dhe procedurave të Doganave Shqiptare në lidhje me NCTS.
- Analiza e hollësishme e sistemit të informacionit të ADSH për ndërveprimin e plotë dhe ndërlidhjen me EU-NCTS.
- Hartimi i Termave të Referencës për zhvillimin dhe zbatimin e sistemit NCTS, bazuar në praktikat më të mira të anëtarëve të sistemeve të BE.

### Ndërtimin e Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit në Qafë-Thanë

Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme të Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar në Qafë-Thanë mundësohet nga Projekti i Bankës Botërore. Në datë 25 nëntor 2021 Kuvendi i Shqipërisë miratoi Marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të R.SH. dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dy Administratat Doganore do të hartojnë protokollet/manualat për procedurat standarde teknike të sipas kushteve të parashikuara në Marrëveshje.

PROTOKOLLI I ZBATIMIT ndërmjet Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Krijimin e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nënshkruar më 10 qershor 2021 në Tiranë në Pikën Ndërkombëtare të Kalimit Kufitar Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut) – Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë u nënshkrua më 14 nëntor 2022 në Shkup, Maqedonia e Veriut.

### Projekti “Lëvizshmëria në Bregun Jonian - COMOBILON”

Në kuadër të Programit Interreg IPA Cross-Border Cooperation “Greqi-Shqipëri 2014 - 2020”, pala shqiptare përfiton nënprojektin 2: ‘Ndërtim, Rindërtim, Rehabilitimi PKK Qafë –Botë’ me buxhet indikativ ~2,3 milion euro. Zbatimi i këtij Projekti ka filluar në 2019 dhe aktualisht jemi në fazën përfundimtare të përgatitjes të specifikimeve teknike për pajisjet që do të prokurohen me fondet e këtij projekti.

### IPA 2013 – Zhvillimi i Moduleve të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Tarifës (ITMS)

Në kuadër të këtij projekti me fond total €2.400.000, parashikohet ndërtimi i një Sistemi të Menaxhimit të Integruar të Tarifës totalisht të përputhshëm me ITMS-në e BE-së, brenda vitit 2023. Aktualisht, në bashkëpunim me ADSH dhe AKSHI-n, Nënkontraktorët e BE-së kanë realizuar softëare-t për modulet e ndryshme të ITMS, si dhe janë siguruar serverët që do të përdoren për implementimin e plotë të Sistemit.

### Projekti i Rrjeti Pan-Evropian i Praktikantëve të Doganave (PEN-CP)

PEN-CP është një projekt 5-vjeçar (shtator 2018 - janar 2024), i financuar nga programi i BE Horizon 2020, i rrjetit të praktikuesve të sigurisë, me 13 administrata doganore evropiane (BE dhe jo BE) - si partnerë aktivë, ndër ta edhe ADSH. Programi PEN-CP mund të përshkruhet si “një Rrjet i ri për nxitjen e inovacionit doganor dhe një platformë on-line, që ofron shërbime të vlefshme ndërmjetësuese të inovacionit”.

Synimi i PEN-CP është të krijojë një rrjet praktikantësh doganorë, i cili lehtëson përkthimin e ideve dhe kërkesave kërkimore dhe inovative për sigurinë doganore në zgjidhje, teknologji dhe përmirësime praktike të procesit, që do të ndihmonin administratat doganore të kapërcejnë sfidat e menaxhimit bashkëkohor të doganave dhe sigurisë së kufijve.

Këtë vit Dogana Shqiptare do të jetë shteti pritës për zhvillimin e Eventit për vitin e 4-të të PEN-CP, i cili do të zhvillohet në 25-28 prill 2023 në Tiranë.

### Programi i DG TAXUD Doganat 2021-2027

Objekti i përgjithshëm i Programit është të mbështesë funksionimin dhe modernizimin e Unionit Doganor me qëllim forcimin e tregut të brendshëm nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, Autoriteteve të tyre Doganore dhe zyrtarëve të tyre.

Pjesëmarrja në Programin “Doganat 2021-2027” do të vazhdojë të ndikojë në forcimin e bashkëpunimit me vendet e tjera pjesëmarrëse të BE-së në këtë Program. Ai shërben si një mjet i rëndësishëm për krijimin e një rrjeti profesionistësh nga vende të ndryshme të BE-së, i cili do t’i ofrojë administratës sonë njohuri teknike specifike dhe shkëmbimin e ekspertizës në: identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha fushat e proceseve doganore.

### Ballkani i Hapur

‘Ballkani i Hapur’, është një iniciativë politike dhe ekonomike, me anë të së cilës tre vendet anëtare (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) synojnë të rrisin tregtinë dhe bashkëpunimin si dhe të përmirësojnë marrëdhëniet dypalëshe. Synimet e Open Balkan janë gjithashtu të ofrojë mundësi më të mëdha për shkëmbime studentore dhe të inkurajojë integrimin në BE të shteteve anëtare. Në kuadër të lehtësimit/eliminimit të barrierave në tregtinë ndërmjet palëve, ADSH ka marrë pjesë dhe ka luajtur rol aktiv në një sërë takimesh dhe aktiviteteve të mbajtura për këtë qëllim, në finale të të cilave u nënshkruan dy marrëveshje për njohjen reciproke të programeve të operatorëve ekonomikë të autorizuar (AEOS), ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Më 25 nëntor 2021 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në zbatim të të cilit do të vijojë puna për draftimin e protokolleve teknike të zbatimit të marrëveshjes për pikën kufitare të Qafë

Thanës, e cila do të ristrukturohet në kuadër të Projekti (rajonal) të Bankës Botërore (BB) “Lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor”.

Në kuadër të kësaj iniciative, gjatë vitit 2022 janë nënshkruar:

- Protokoli ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për krijimin e pikave të përbashkëta kufitare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pikën ndërkombëtare kufitare Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut) – Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë).
- Protokoli ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Protokoll ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Serbisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë.

#### Projekti EXBS

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka një bashkëpunim shumë të mirë dhe me Programin EXBS (Export Control and Related Border Security). Në kuadër të këtij bashkëpunimi në nëntor 2022, Dogana mori pjesë në Takimin e Pesëmbëdhjetë (XV) POC të Iniciativës së Kufirit Jugor, në Prishtinë, Kosovë, me pjesëmarrjen e dy Këshilltarëve Rajonalë të EXBS, Daën Verdugo dhe Rossitza Petrov. Në takim të pranishëm ishin delegacionet e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Përveç përmirësimit të klimës së biznesit dhe tregtisë duhet patur parasysh edhe pjesa e sigurisë së vendeve dhe se lehtësimi i tregtisë shkon krah për krah dhe me forcimin e sigurisë. Sulmet kibernetike janë dhe ngelen një problem dhe do shihet mundësia e ndihmës nga ana e programit EXBS të ambasadës USA në vendet përkatëse dhe nga Departamenti i Shtetit.

Shumë e rëndësishme shihet shkëmbimi i informacionit mes shteteve. Është sugjeruar që të sigurohet një trajnim për ManPad dhe ATGM (anti tank guided missiles). Nga pala shqiptare është kërkuar trajnimi për Min Pad dhe për ATGM, si dhe mundësia e pasjes së pajisjeve për të detektuar këto armë.

Gjithashtu në muajin tetor përfundoi kursi njëjavor i Trafikimit të Armëve të Vogla. Kursi u fokusua në fushat që lidhen me trafikimin e armëve të zjarrit, duke përfshirë identifikimin e armëve të zjarrit, gjurmimin e armëve të zjarrit, identifikimin e armëve të zjarrit të bëra vetë dhe të falsifikuara, printimin 3D të armëve të zjarrit, shfrytëzimin e mediave sociale, teknikat e hetimit të armëve të zjarrit në internet, sigurinë operacionale dhe planifikimin operacional dhe teknikat e zbulimit të intervistave dhe mashtrimeve.

Delegacionet nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Sllovakia morën pjesë në kurs.

## VII.2. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare

Shqipëria është anëtare e OBD-së që prej gushtit 1992, dhe që prej asaj kohe merr pjesë aktivisht në takimet e Këshillit të OBD-së, komiteteve dhe nën komiteteve, duke përfituar nga eksperiencat më të mira të vendeve të zhvilluara dhe duke i implementuar ato në sistemin tonë doganor.

Gjithashtu vendi ynë kontribuon me informacionin e vet në përgatitjen e raporteve vjetore dhe të analizave 6 mujore të vlefshme dhe gjithëpërfshirëse të OBD-së, për zbatimin e ligjeve të ndryshme dhe marrëveshjeve mbi shkeljet në fushën doganore.

Gjatë viteve të fundit, Dogana Shqiptare ka marrë pjesë intensivisht në programet e ndryshme trajnuese të OBD-së të cilat synojnë të investojnë tek menaxherët e mesëm me potencial të lartë dhe të zgjerojnë mundësitë, aftësitë dhe njohuritë e tyre, në mënyrë që të marrin pjesë aktivisht në procesin reformues dhe modernizues të administratës së tyre.

### VII.2.3. Takime dypalëshe

Në funksion të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe apo marrëdhënieve ndërkombëtare janë organizuar vizita të delegacioneve doganore të huaja në Republikën e Shqipërisë dhe të delegacioneve të Doganës Shqiptare jashtë. Në këtë kuadër është koordinuar puna mbi zhvillimin e takimeve të nivelit të lartë/ bilaterale/ multilaterale me administratat doganore të vendeve fqinje:

- Takim i drejtorëve të kufirit dhe drejtorëve të doganave të vendeve të Ballkanit (15 -17 mars 2022, Ohër, Maqedoni e Veriut);
- Takimi i 7-të Rajonal Informal i Nivelit të lartë të drejtorëve të Administratave Doganore të Ballkanit Perëndimor (WB6), Budva, Mali i Zi, (22 - 23 mars 2022);
- Takimi i 8 rajonal Informal i nivelit të lartë të Administratave Doganore të Ballkanit Perëndimor (WB6), (24-26 tetor 2022);
- Takim mbi sistemet e IT, Stamboll, Turqi

- Takimi i përfaqësuesve të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë,
- Vizitë pune në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë Turke
- Takimi Bilateral i Administratës Doganore Shqiptare me Administratën Doganore të Kosovës - Mbi zbatimin e Marrëveshjes
- SEED + Nënshkrimi i Protokollit të Mirëkuptimit (Blue Line)
- Forumi i konektivitetit në Selanik - Plani ekonomik dhe i investimeve të BE-së në Ballkanin Perëndimor
- Konferenca Rajonale e OEA Avancimi i Programit të OEA në Rajon.

### VII.3. Marrëveshje Ndërkombëtare në zhvillim

- Aktualisht kemi në proces Projekt Marrëveshjen me Izraelin, "Asistenca e ndërsjellë administrative në fushën doganore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Izraelit" dhe jemi në pritje të finalizimit të saj.
- Aktualisht kemi në proces projektvendimin "Për Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bjellorusisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Për Bashkëpunim dhe Asistencë Reciproke në Çështjet Doganore".
- Aktualisht kemi në proces "Projektmarrëveshjen mbi bashkëpunimin dhe asistencën e përbashkët në çështjet doganore" me Arabinë Saudite.

### VII.4 Procesi i Integritimit Evropian

Procesi i integritimit i Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) është konsideruar si prioriteti më strategjik kombëtar, i cili udhëheq agjendën qeverisëse të vendit. Në qershor të vitit 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asocimit, e cila hyri tërësisht në fuqi në prill të vitit 2009. Që nga qershori i viti 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në BE. Marrja e statusit të vendit kandidat shënon një hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE, pasi reflekton ecurinë e reformave të ndërmarra dhe i hap rrugë procesit të plotë të aderimit të vendit në BE.

Aktualisht Shqipëria ka hapur Negociatat për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si institucion është jo vetëm e përfshirë drejtpërdrejt në dhënien e kontributit të saj në Kapitullin 29 "Bashkimi Doganor", por është njëkohësisht institucion kontribuues edhe në Kapitullin 1 "Lëvizja e lirë e mallrave", Kapitullin 7 "E drejta e Pronësisë Intelektuale", Kapitullin 16 "Tatimet", Kapitullin 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", Kapitullin 30 "Marrëdhëniet me Jashtë" dhe Kapitullin 33 "Dispozitat Financiare dhe Buxhetore".

Në këtë kuadër janë përmbushur detyrimet e DPD në lidhje me:

- Kontributin për Raportin e Progresit për Kapitullin 29 “Doganat”;
- Nënkomitetin BE-Shqipëri “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet” si dhe “Drejtësia, Liria dhe Siguria”; (29 qershor 2022)
- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023 – 2025.
- Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitullin 29;
- Hartimin e Projekt-Pozicionit Negociues për Kapitullin 29 “Doganat”;
- Monitorimin për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian për vitin 2021 për Kapitullin 29 “Doganat”.

Në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mori pjesë në Takimet shpjeguese ‘Screening’ mbi acquis, për kapitujt ku Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është kontribuuese, përmendim Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave” i cili u zhvillua më 10 tetor 2022, Kapitulli 7 “E drejta e Pronësisë Intelektuale” i cili u zhvillua më 12 tetor 2022, Kapitulli 16 “Tatimet” i cili u zhvillua më 21 tetor 2022 dhe Kapitulli 29 “Doganat” i cili u zhvillua më 20 tetor 2022)

Takimet shpjeguese për Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” dhe Kapitullin 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore” pritet të zhvillohen përkatësisht në 26 shtator 2023 dhe në 20 korrik 2023.

Lidhur me takimet bilaterale, aktualisht janë zhvilluar takimi bilateral për kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” (8-10 nëntor 2022) dhe takimi bilateral për kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale” (18-19 janar 2023).

Ndërkohë, kanë filluar përgatitjet për Takimin Bilateral për Kapitullin 29 “Doganat”, i cili pritet të zhvillohet në datat 5 dhe 6 qershor 2023, ndërsa Takimi Bilateral për Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave” u zhvillua më 30 janar – 2 shkurt 2023, Kapitullin 16 “Tatimet” pritet të zhvillohet më 29-30 mars 2023, Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” pritet të zhvillohet më 23 nëntor 2023 dhe për Kapitullin 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore” pritet të zhvillohet më 25 tetor 2023.

Me qëllim rritjen e transparencës me publikun dhe reflektimin e saktë dhe të qartë të veprimtarisë dhe arritjeve të punës së ADSH, për vitin 2022, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare ([www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)) të institucionit janë publikuar rregullisht aktivitetet e ndryshme të saj, kapjet dhe zbulimet në kuadër të luftës kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme (trafikimin e substancave narkotike, vlerave monetare, klandestinëve, mallrave të akcizës, etj.), si dhe njoftimet për operatorët ekonomikë dhe individët mbi risitë dhe lehtësitë në procedurat doganore, përmirësimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, punësimin në administratën doganore, etj.

## VIII. Rritja e kapaciteteve administrative

Administrata doganore është përgjegjëse për të siguruar që punonjësit e saj të kenë aftësitë dhe njohuritë e duhura për të përmbushur objektivat strategjike dhe operacionale të organizatës.

Për rritjen e aftësimin profesional dhe në përputhje me nevojat e punonjësve, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 131 trajnime, ku janë trajnuar 1144 punonjës të Administratës Doganore (shifra nënkupton që një punonjës është trajnuar më shumë se një herë).

Në programet e trajnimeve të hartuara sipas nevojave, janë përfshirë tema nga fusha të ndryshme të administratës doganore, por edhe tatimore, për aftësimin profesional të personelit në vijim të ndryshimeve legjislativ/procedurave, etj., si dhe praktikat më të mira në shërbim të biznesit, ku synohet të mbulohen të gjitha fushat e aktivitetit të Administratës Doganore, lidhur me procedurat dhe detyrimet doganore, borxhin doganor, vlerën doganore, produktet e akcizës, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë që zbaton Shqipëria, etj.

Në realizimin e trajnimeve përdoret në një masë të gjerë ekspertiza e punonjësve tanë me njohuri dhe eksperiencë të thelluar në fushën doganore. Trajnimet zhvillohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe në Degë Doganore

Trajnimet janë zhvilluar në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, ku mund të përmendet:

- QTATD (Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore);
- ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike);
- DAP (Departamenti i Administratës Publike), Kryeministria, Ministria e Ekonomisë dhe Financës, Ministria e Mbrojtjes;
- ILDKPKI (Inspektoriati I Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave);
- OBD (Organizata Botërore e Doganave);
- EXBS (Programi i Kontrollit të Eksporteve dhe Sigurisë Kufitare
- USAID (United States Agency for International Development);
- CEFTA (Central European Free Trade Agreement);
- IPA 2013;
- TAIEX (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit në Komisionin Europian);
- GIZ (Fondi i Hapur Rajonal për Promovimin e Tregtisë së Jashtme)
- UNOCD (United Nations Office on Drugs and Crime);
- Uk Border Force;
- SEI, "Support to the EU Integration Process of Albania"
- RACVIAC (Centre For Security Cooperation);

- EUROPOL “The European Union Agency for Law Enforcement Cooperation”
- EU4FOCAL;
- Departamentin e Energjisë (SHBA),
- AEC-Albania “Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”
- Njësia e Ozonit
- Ambasada Amerikane);

### a) Punësimi i Ekselentëve

Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 586, datë 30.08.2019 për “Punësimin e Përkohshëm të Studentëve të Ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore”. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave gjatë vitit 2022 ka punësuar 4 studentë ekselentë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve të saj Doganore.

Kjo platformë është një mundësi e shkëlqyer punësimi për studentët e ekselencës të diplomuar brenda dhe jashtë vendit, të cilët janë në kërkim të një eksperience në administratën publike. Të rinjtë duhet të kenë mbaruar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor dhe/ose master profesional/shkencor me mesatare 9.00-10.00 (ose të barasvlershme me to) në secilin prej cikleve të studimit.

Falë kësaj mundësie, ekselentët do të përfitojnë një përvojë kualifikuese, e cila do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive profesionale, duke u përballur me administratën publike në një tjetër nivel, e duke kuptuar më mirë vazhdimësinë e rrugëtimit të karrierës së tyre.

### b) Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është mundësuar Programi i Praktikave të punës për të rinjtë nga mosha 21-26 vjeç që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor.

Kjo është një mundësi shumë e mirë për të rinjtë për të përfituar një përvojë kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale pranë institucionit tonë shtetëror.

Në vitin 2022 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave janë pranuar 7 aplikantë për të zhvilluar praktikën profesionale të punës nga 25 aplikime gjithsej. Ky program shërben për realizimin e detyrave dhe angazhimeve në institucion, bazuar në një plan pune tre – mujor, të drejtuar nga një mbikëqyrës. Pas përfundimit me sukses të fazës së parë të programit do të pajisen me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Departamenti i Administratës Publike.



## IX. PRIORITETET 2023

Objektivi ynë për vitin 2023 është avancimi drejt dixhitalizimit dhe novacionit duke u përfshirë në projekte të rëndësishme me mbështetjen e DG Taxud dhe FMN-së, si projekti “Single Window” apo projekti “One-Stop-Shop”, që do të ofrojnë shërbimet në vetëm një dritare për biznesin, sistemi i ri i tranzitit ndërkombëtar, sistemi integruar i menaxhimit të tarifave, përmirësimi infrastrukturës së degëve doganore etj.

Prioritetet kryesore për vitin 2023 për Administratën Doganore do të jenë si vijon:

1. Modernizimi i sistemit IT për Doganat me shërbimet online dhe aplikacione të reja në funksion të lehtësimit të procedurave. Evidentimi projekteve/aplikacioneve të reja në bashkëpunim me AKSHI-n. Implementimi aplikacioneve(apps) të reja për përdoruesit konsumatore/biznese
2. Nation Single Window (Sporteli: Një Dritare e Vetme) i referohet hartimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, modelit të Qeverisjes dhe Operacional, modelit të të ardhurave dhe strukturës së pagesave për funksionimin e NSW, ndërtimi i Arkitekturës dhe Specifikimeve Teknike e Funksionale për Sistemin NSW marrëveshjet mbi shërbimet për institucioneve pjesëmarrëse në NSW.
3. Join BCP of Qafë Thana (One Stop-Shop: Pika e përbashkët Doganore Qafë Thanë me Maqedoninë e Veriut). Finalizimi i protokollit të përbashkët për procedurat standarde të operimit që mundëson veprimet e deklarimit të mallrave sipas parimit “një ndalesë - një kontroll”
4. NCTS \_Common Transit (Sistemi i Tranzitit Ndërkombëtar). Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit dhe Regjistrimi dhe Identifikimi i Operatorit Ekonomik (EORI) plotësisht në përputhje me EU-NCTS si dhe vendosja e TI-së e moduleve për zbatimin NCTS duke përfshirë sistemin kombëtar të TI-së që krijon lidhje me domenin e përbashkët të BE-së përmes “CCN/CSI” / “SPEED2.
5. Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave (ITMS):përfundimi i zhvillimit të softit nga ekspertët e SIVCO dhe realizimi i ndërveprimit me ASYCUDA për implementimin e ITMS në bashkëpunim me ekspertët e UNCTAD.
6. Ndjekja e procedurave të nevojshme për ri akreditimin e Laboratorit Doganor, në përputhje me kërkesat e Standardit SSH ISO/IEC 17025:2017.
7. Përmirësimi i infrastrukturës dhe vizualitetit të 6 degëve doganore kufitare në kuadër të projektit “Portat e Shqipërisë, rehabilitimi i portave hyrëse dhe dalëse në RSH”, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës me projekte të financuara nga buxheti shtetit;

## XI. Kontaktet:

### DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

**Adresa postare:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,  
autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5, Tiranë.

**Numra kontakti:**

**Help Desk**

Tel: +355 42 232 988  
orari 08:00- 24:00/ 7 ditë)

**e-mail:** [helpdesk.dpd@dogana.gov.al](mailto:helpdesk.dpd@dogana.gov.al)

**Info Point**

Tel: +355 42 253 820  
(orari 8.00 - 16.00 nga e hëna në të premte)

**Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale**

e-mail: [antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al](mailto:antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al)

**Zv.Drejtor i Përgjithshëm Administrativ**

e-mail: [zvdrejtoradministrativ@dogana.gov.al](mailto:zvdrejtoradministrativ@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

e-mail: [burimenjerezore.dpd@dogana.gov.al](mailto:burimenjerezore.dpd@dogana.gov.al)

**Zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik**

e-mail: [zvdrejtorteknik@dogana.gov.al](mailto:zvdrejtorteknik@dogana.gov.al)

**Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Akcizës**

e-mail: [zvdrejtorkacize@dogana.gov.al](mailto:zvdrejtorkacize@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Origjinës dhe Tarifës**

e-mail: [sorigjina.dpd@dogana.gov.al](mailto:sorigjina.dpd@dogana.gov.al) ,  
[starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Procedurave dhe Garancive**

e-mail: [sprocedurat.dpd@dogana.gov.al](mailto:sprocedurat.dpd@dogana.gov.al)

**Drejtoria Juridike**

e-mail: [juridiku@dogana.gov.al](mailto:juridiku@dogana.gov.al)

**Zv.Drejtor i Përgjithshëm Operativ Hetimor**

e-mail: [zvdrejtordoh@dogana.gov.al](mailto:zvdrejtordoh@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Informacionit**

e-mail: [drejtoriainformacionit.dpd@dogana.gov.al](mailto:drejtoriainformacionit.dpd@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Analizës së Riskut**

e-mail: [risku@dogana.gov.al](mailto:risku@dogana.gov.al) ,  
[monitorimi@dogana.gov.al](mailto:monitorimi@dogana.gov.al)

**Drejtoria e Pronësisë Intelektuale**

e-mail: [ipr@dogana.gov.al](mailto:ipr@dogana.gov.al)



Për denoncime numër pa pagesë:  
0800 22 22

